

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI

PRISHJE DHE TRANSPORT I INERTEVE TË GJENERUARA NË KUADËR TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË BASHKINË VORË

Baza Ligjore

Në mbështetje të Aktit Normativ nr. 9 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 34 për ndërtesat që kanë pësuar dëme dhe që janë shpallur të pabanueshme nga akt konstatimet apo aktvlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit, grupet përkatëse të inspektimit, për garantimin e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore kanë kryer aktekspertiza të thelluara për të gjitha ato objekte kur sipas akt konstatimeve ose aktvlerësimeve paraprake të Institutit të Ndërtimit dhe grupet përkatëse të inspektimit, është kërkuar një rivlerësim më i thelluar.

Në zbatim të PDyV Vorë dhe bazuar në aktekspertizat e thelluara të kryera për objektet e dëmtuara dhe të mbështetura nga oponencat teknike të Institutit të Ndërtimit, Vendimeve të Këshillit Bashkiak për prishjen e detyruar të ndërtesave si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 në territorin e Bashkisë Vorë, hartohet relacioni mbi prishjen e objekteve të shpallura të rrezikshme për banim dhe evadimin e mbetjeve të ndërtesave që do të prishen.

Objektet që do t'i nënshtrohen prishjes së detyruar

- Objektet e shpallura me nivel dëmi DS5 brenda zonës së shpallur për rindërtim në qytetin e Vorës dhe transporti i inerteve.
- Objektet për shpronësim në kuadër të zbatimit të PDyV Vorë dhe transporti i inerteve.
- Prishja e qendrës shëndetësore Prezë dhe transporti i inerteve.
- Prishja e pallateve me shkallë dëmi DS5 në fshatin Marqinet dhe transporti i inerteve.
- Prishja e pallateve me shkallë dëmi DS5 në fshatin Ahmetaq dhe transporti i inerteve.

Lista e detajuar e objekteve të miratuara për prishje të detyruar shoqëruar me specifikimet përkatëse

- **Prishje në qytetin e Vorës**

Pallati nr. 3 (me nr. pasurie 2/51, zk 3127) Rruga Rinia, Vore – Ky është një objekt me pesë kate me ndarje me soletë monolite b/a i ndërtuar me muraturë tulle të plotë 25 cm x 12 cm x 6 cm dhe i mbuluar po me soletë. Gjithashtu në krahun veri-lindor të këtij objekti do të shemben dhe disa shtesa të cilat janë shpronësuar dhe struktura e tyre është sistem tra/kolone b/a me murature tulle dhe soletë.

Pallati me nr pasurie 2/2, zk 3127, rruga Unaza – Ky është një objekt me pesë kate me ndarje me soletë

monolite b/a i ndërtuar me muraturë tulle të plotë 25 cm x 12 cm x 6 cm dhe i mbuluar po me soletë. Objekt në pronësi private dy katësh me çati – Ky objekt është me muraturë me tulla të plota 25 cm x 12 cm x 6 cm me ndarje kati me dysheme dhe mbulesë me çati me tjegulla vendi.

Objekte dy katësh në pronësi private të ndodhura në krahun veri-perëndimor të bllokut nr. 4 në gjurmë të infrastrukturës rrugore – Këto objekte janë ndërtime me tulla të plota dhe me ndarje katesh me soletë monolite b/a. Gjithashtu mbulimi i tyre është i realizuar me soletë.

Dy objekte në pronësi private një katësh – Këto objekte ndodhen në krahun veri-perëndimor të zonës për rindërtim në Vorë dhe prishen pasi janë në gjurmë të infrastrukturës rrugore. Janë ndërtime me tulla dhe mbulesë me çati me tjegulla vendi.

Godinë dy katëshe në pronësi private në rrugën Mema – Ky objekt priset për zbatimin e bllokut nr. 5.

Godinë në pronësi private një katëshe – Këto objekte janë një katëshe me muraturë tulle dhe soletë dhe prishen për zbatimin e infrastrukturës rrugore.

Objekt privat në pronësi të z. Gazmir Poka – Ky objekt priset për zbatimin e projektit të bllokut nr. 2. Është një objekt një katësh me muraturë tulle i mbuluar me soletë b/a.

Objekt privat në pronësi të z. Isuf Drita Daja – Ky objekt priset për zbatimin e projektit të infrastrukturës rrugore dhe është objekt një katësh me muraturë tulle dhe soletë b/a.

Objekt privat në pronësi të z. Gazmir Domi – Ky objekt ndodhet në rrugën Unaza dhe shembet në kuadër të zbatimit të projektit të Infrastrukturës. Është një objekt tre katësh me muraturë me tulla të lehtësuara dhe soleta b/a, i mbuluar po me soletë b/a.

Godina e Bashkisë Vorë – Kjo godinë ndodhet në rrugën Unaza është tre katëshe dhe është e ndërtuar me tulla dhe sistem tra/kolonë b/a me ndarje të kateve dhe mbulesë prej solete b/a.

Shkolla e mesme Vorë – Kjo shkollë është një objekt me tre kate me ndarje me soletë monolite b/a i ndërtuar me muraturë tulle të plotë 25 cm x 12 cm x 6 cm dhe i mbuluar me soletë.

- **Prishje në fshatin Prezë**

Prishja e qendrës shëndetësore Prezë – Godinë dy katëshe me muraturë tulle, ndarje katesh dhe mbulesë me soletë b/a.

- **Prishje në fshatin Marqinet**

Prishja e pallateve Marqinet – Objektet janë dy dhe janë dy kateshe. Struktura mbajtëse është prej murature me tulla të plota, ndarja e kateve realizohet me soleta b/a ndërsa mbulesa me çati me tjegulla.

- **Prishje në fshatin Ahmetaq**

Prishja e pallatit Ahmetaq – Objekti është dy katësh. Struktura mbajtëse është prej murature me tulla të plota, ndarja e kateve realizohet me soletë b/a ndërsa mbulesa me çati me tjegulla.

TE PERGJITHSHME

Të gjitha punimet që do të kryhen duhet të jenë në përputhje me kushtet teknike të zbatimit në fuqi. Të gjithë manovratorët do të jenë të pajisur me liçensat apo kualifikimet përkatëse. Në rast se gjatë punës në terren do të lindë e nevojshme kryerja e punimeve të tjera të paparishikuara në preventiv të merret aprovimi i autoritetit kontraktor.

Organizimi i punimeve.

Përpara fillimit të punimeve do të realizohet rrethimi i sheshit të ndërtimit i cili mund të jetë i veçantë për secilin prej objekteve apo për një grup prej tyre. Do të merren masa që të ndalohet reptësisht hyrja e personave të paautorizuar brenda kantierit të punimeve.

Do të merren masa për mbajtjen pastrë të ambientit dhe kontrollin e pluhurave të krijuar nga shembja duke sperkatur vendin me ujë nepermjet cisternave të instaluar në kantier apo autocisternave.

Përpara shembjes të sigurohet boshatisja e plotë e objekteve nga njerëzit.

Do të sigurohet që brenda objekteve nuk ka sende të cilat mund të përbejnë rezik për një shembje të pakontrolluar siç mund të jenë depozita uji, bombula gazi, depozita karburanti, depozita apo cisterna të lendeve të ndryshme kimike apo çdo lloj objekti tjetër i cili mund të verë në rezikshmëri punonjesit gjatë procesit të prishjes. Në rast se brenda godinave do të konstatohen objekte të tilla procedura për largimin e tyre duhet më parë të aprovohet me shkrim nga mbikqyrësi i punimeve.

Përpara shembjes do të shkëputen të gjitha lidhjet e infrastruktures mbeshtetëse si lidhja me energji elektrike, furnizimi me ujë, kuz, rrjetet e komunikimit me shpejtësi të lartë, kabllot televizive etj.

Inertet e gjeneruara nga objektet e shembura do të ngarkohen në mjetet e transportit me ekskavator me kovë ose fadromë. Objektet e pa shembura fillimisht do të shemben, do të realizohet thyerja e elementëve prej betony apo betony të armuar dhe më pas do të ngarkohen në mjet.

Do të sigurohet që mjetet që do të dalin nga kantieri të jenë të pastra për të mos shkaktuar ndotje jashtë rrethimit të kantierit.

Inertet e gjeneruara do të depozitohen në një pikë të miratuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për çdo paqartësi në zërat e punimeve të preventivit dhe specifikimet teknike do të merret mendimi dhe aprovimi i inxhinierit përfaqësues të Autoritetit Kontraktor dhe mbikqyrësit të punimeve.